



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:083962  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05636568

Ac.nr.4341/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Nehat Idrizi dhe Dardan Kadolli anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.K. nga Shtimja, rr. “...” nr..., të cilin e përfaqëson V.M., avokat në Ferizaj, sipas autorizimit, kundër të paditurit T.K. nga Shtimja, rr. “...” nr..., tani me vendbanim të përkohshëm në Shtime, rr. “...” nr..., për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.458/17, datë 14.08.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditësit Xh.K. nga Shtimja, rr. “...” nr..., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.458/17, i datës 14.08.2020, në pikën I dhe III, të dispozitivit VËRTETOHET.
- II. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën II, të dispozitivit.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.458/17, të datës 14.08.2020, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Xh.K. nga Shtimja, rr. “...” nr..., ushtruar kundër të paditurit T.K. nga Shtimja Rr. ”.....” nr..., lidhur me kthimin e borxhit në shumën prej 20,700.00 Euro. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Konstatohet se është tërhequr padia e paditësit Xh.K. nga Shtimja Rr. ”... ..” nr...,

ushtruar kundër të paditurit T.K. nga Shtimja Rr. ”....” nr....., lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë në parcelën me numër .... me sipërfaqe prej 32 m2 ZK Shtime. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që: Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe të detyroj të paditurin ti paguaj borxhin në lartësi prej 20.700 € si dhe shpenzimet e procedurës, ose aktgjykimin e atakuar ta prish dhe të njëjtin t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, duke kërkuar edhe shpenzimet për përpilimin e ankesës sipas TOAK-së dhe taksat gjyqësore 31 €.

Me përgjigje në ankesë i padituri i ka kontestuar në tërësi të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit, me propozim që ankesa të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 02.06.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kthimin e borxhit në vlerë prej 19.700€, apo vërtetimin e pronësisë në ngastrën kadastrale..., në sipërfaqe prej 32m2 ZK Shtime. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.06.2020, ka bërë rregullimin e padisë në aspektin objektiv, duke kërkuar të detyrohet i padituri që t’ia kthej borxhin paditësit në shumën prej 20.700 €, ndërsa ka tërhequr padinë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në parcelën nr. ....

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.458/17, të datës 14.08.2020, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me qëllim të vërtetimit të drejtës të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse i kanë parashtruar ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e Aktgjykimit P.nr.1557/15 të datës 20.11.2017, i plotfuqishëm me datë 07.03.2018, përmes së cilit vërtetohet faktet vendimtare në këtë çështje kontestimore të cilat janë: se paditësi përmes tij është shpallur fajtor për veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga nenin 332.1 të KPRK dhe është dënuar me dënim me kusht prej 6 muajve i cili nuk do të ekzekutohet në qoftëse i padituri brenda një vit pasi ky aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale. Paditësi pretendon se për shkak të lirimit të kësaj prone është dakorduar me të paditurin që ky i fundit t’ia paguaj shumën prej 23,700.00, prej tyre ia ka paguar shumën prej 3,700.00, ndërsa shumën tjetër jo. Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit nuk ka bazë juridike për pagimin e shumës së pretenduar nga ana e të paditurit dhe për këtë arsye kërkesa e tij është refuzuar në tërësi si e pa bazuar. Kërkesa nuk ka bazë juridike për kompensim, përkatësisht nuk e ka themelësinë në prova materiale, me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar baza juridike dhe aq ma pak lartësia e kërkesëpadisë. Në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit. Gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë raport juridik-civil përmes punës së vlefshme juridike të lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse të huadhënies,

përkatësisht të huamarrjes. Paditësi pretendon mbrojtjen e të drejtës së tij subjektive nga një raport juridik i paqenë, po ashtu pretendon kthimin e mjeteve financiare për shkak të lirimit të lokalit të të paditurit, ku për këtë lokal paditësi është shpallur fajtor për veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga nenin 332.1 të KPRK. Paditësi ka dështuar të provojë me prova raportet juridike të krijuara me të paditurin për themelimin, ndryshimin apo shuarjen, në bazë të fakteve juridike, e të cilat më pastaj kanë mbështetje në të drejtën materiale. Sa i përket vendimit në pikën II të dispozitivit gjykata ka parashtruar se këtë vendim e mori për arsye se paditësi përmes të autorizuarit të tij në seancën përgatitore të datës 18.06.2020 është tërhequr nga kërkesa për vërtetimin e të drejtës në pronë, ndërsa me këtë tërheqje është pajtuar i padituri, andaj bazuar në nenin 261.2 të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e II, të aktgjykimit të atakuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 31 dhe 54 të LMD-së, neneve 22 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me nenin 143 dhe 261 paragraf 2 të LPK-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka mbështetur në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata ka ardhur në përfundim të drejtë se në këtë rast nuk ekziston detyrimi juridik i të paditurit ndaj paditësit në shumën prej 20.700€. Për më shumë, paditësi kërkesën nga padia e mbështet në një marrëveshje të arritur në vitin 2011, (mes tij dhe të paditurit) për ndarjen e pasurisë familjare, në atë mënyrë që paditësi kishte pranuar që në emër të kompensimit i padituri t'i paguaj shumën prej 23.000€, ndërsa deri në realizimin përfundimtar të kësaj pagese paditësi ta ketë të drejtën e shfrytëzimit të një lokali në sipërfaqe prej 16m<sup>2</sup>. Këto deklarime sa i përket detyrimit monetar edhe nëse do të ishin të qëndrueshme, megjithatë sipas gjetjeve të gjykatës ankimore paditësi në të vërtetë ka rënë në vonesë për të kërkuar nga i padituri kompensimin e shumës së pohuar, pasi padinë në gjykatë e ka paraqitur në vitin 2017, gjegjësisht gjashtë vite pas marrëveshjes së pohuar. Ndërsa, i padituri me parashtrësën e datës 19.06.2020 dërguar gjykatës së shkallës së parë është thirrë në parashkrim të kërkesës, por që gjykata, aktgjykimin për refuzimin e kërkesëpadisë nuk e ka arsyetuar në këtë drejtim.

Nga këto, Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse në bazë të 245 paragrafi 1 të po këtij ligji, përcaktohet se: "Kreditori në marrëdhënien e detyrimit, ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen

e tij”. Në kuptim të këtyre dispozitave, rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, sepse pala paditëse me as një provë të vetme nuk ka arritur ta argumentoj faktin se në këtë rast ka cilësinë e kreditorit ndërsa i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Pika II, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën me të cilën është konstatuar tërheqja e padisë së paditësit nuk është shqyrtuar, sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e tërhequr të padisë së paditësit lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.4341/20, me datë 12.04.2024

Kryetare e kolegjit  
Hunaida Pasuli